

ZBULVESIT

Viti 1 - Tremujori 3
Programi Bazë



NJË MESAZH NGA KRIS SMOLL

Të dashur drejtues,

Kur shërbeni me fëmijët jeni duke investuar brenda shpirtërave të nxënësve që hyjnë përmes derës së kishës. Vetëm Perëndia e di se me çfarë do të përballen ata gjatë javës, muajit, vitit të ardhshëm apo përgjatë jetës së tyre. Megjithatë, diçka është e sigurt – po të kenë një marrëdhënie të thellë e personale me Perëndinë, ata mund të dinë me bindje se Perëndia është me ta dhe do të mund të bëjnë zgjedhje të mençura. Filipianëve 3 na sfidon të këmbëngulin e të vazhdojmë t'i shërbejmë Atij me gjithë zemër pavarësisht çmimit. Nuk e bëjmë sepse jemi të detyruar. E bëjmë sepse kemi kuptuar çmimin që pagoi Jezusi për të na shpëtuar nga mëkatet tona dhe mbushemi me gëzimin e madh që vjen vetëm prej Tij. Duke qenë të themeluar në një botëkuptim biblik ne mund të jetojmë me siguri ndërsa u dëshmojmë nxënësve tanë për madhësinë e Perëndisë.

Ndërsa nisim këtë tremujor le të mbështetemi në fuqinë e Frymës së Shenjtë, le t'i mësojmë nxënësit me pasion – ashtu si Pali, dhe të mos e harrojmë për asnjë çast thirrjen që Jezusi ka për jetën tonë.

Gati?

Sot. Nesër. Ne përjetësi.

Kris Smoll

Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

TABELA E PËRMBAJTJES

Viti 1 – Tremujori 3

Të kuptojmë kurikulën.....	4
Përmbledhja e tremujorit.....	9
Mësimi 1: Jezusi u mëson njerëzve për delen e humbur.....	12
Mësimi 2: Jezusi u mëson njerëzve për birin e humbur.....	21
Mësimi 3: Jezusi ndryshon Zakeun.	30
Mësimi 4: Dishepujt marrin pjesë në Darkën e Fundit.....	37
Mësimi 5: Jezusi vdiq dhe u ringjall.	43
Mësimi 6: Perëndia e ndryshon Saulin.	50
Mësimi 7: Lidia identifikohet me Jezusin.	57
Mësimi 8: Pali dhe Sila dëshmojnë në burg.....	65
Mësimi 9: Pali nis udhëtimin e tij misionar.	73
Mësimi 10: Perëndia e mbron Palin nga stuhitë dhe nga gjarpërinjtë.	79
Mësimi 11: Pali qëndron i patundur për Jezusin në Romë.	86
Mësimi 12: Dita e përsëritjes.	92
Shtojca	
Mësim tematik: Perëndia na shpëtoi përmes hirit.....	95
Lojërat e fundit të përsëritjes	102
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin	107
Falënderimet dhe lejet	109

TË KUPTOJMË KURIKULËN

Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbuluesen e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimin përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

Kupto si duhet:	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
Mendo si duhet:	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
Vepra si duhet:	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
Ndihu si duhet:	Rezultati i zbatimit të mësimin dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

Mësuesi kryesor: Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

Drejtuesi i kohës së zbulimit: Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikul.

Bariu: Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

Këshilla për drejtuesin

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

Pasqyra bazë e programit

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektiv të Hartës së gjurmuesit.

Program i sugjeruar

- : 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë
- : 15 Loja e përsëritjes
- : 00 Adhurimi
- : 15 Koha e zbulimit
- : 30 Mësimi nga Bibla
- : 60 Loja e fundit e përsëritjes
- : 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

Loja e përsëritjes

Këshilla për drejtuesin

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiku t'i bashkoh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

Adhurimi

Këshilla për drejtuesin

Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mëimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mëimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

Këshilla për drejtuesin

Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mëimit:

Kreu i seksionit: Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).

Lexo: Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.

Përmbledhje: Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.

Parafrazim: Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën “Vepro si duhet” te mësimi.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që “t’i jepni jetë Biblës”, duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t’i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t’i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin “Gjejeni” në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

Loja e fundit e përsëritjes

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

Këshilla për drejtuesin

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t’i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Poster *Ndihë si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimin dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

Kursi i këmbimit:

- 3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
- 2 Pjesëmarrja aktive në klasë
- 1 Shfaqja e frytit të Frymës
- 1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikulum)
- 5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
- 10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

Thesaret i gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.

PËRMBLEDHJA E TREMUJORIT

Viti 1 – Tremujori 3

Këtë tremujor do të përfundojmë studimin tonë lidhur me jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit, në librin e Lukës. Për më tepër do të mësojmë për jetën e mrekullueshme të apostullit Pal në librin e Veprave dhe do të shohim se si vepron Perëndia në ndarjen e së vërtetës të Shpëtimtarit tonë deri në skajet e dheut. Lutja jonë është që Perëndia ta përdorë këtë studim si ndihmë që nxënësit të besojnë në Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tyre, dhe se ata që besojnë në Të do të përjetojnë rritje jetëndryshuese frymërore.

Jezusi tregoi shëmbëlltyrën e deles së humbur për t'i ndihmuar njerëzit të kuptonin rëndësinë e arritjes së të humburve për Krishtin. Çdo dele ishte e vlefshme për Kryebariun dhe Ai i donte shumë ato. Kjo ngjarje na sfidon të kërkojmë vazhdimisht për njerëzit e humbur që kanë nevojë për Jezusin.

Përgjatë shërbesës së Tij, Jezusi bëri mrekulli të pamohueshme. Ai i mësoi njerëzit me autoritet qiellor dhe Ai jetoi një jetë të pamëkat. Pavarësisht këtyre fakteve, Ai u përball me rezistencë të madhe nga shumica e drejtuesve judenj, sepse ata nuk arrinin t'i lidhnin zemrat e tyre me të vërtetën e dukshme të Ungjillit. Në fakt, ata shihnin me përçmim “mëkatarët” dhe besonin se gjenealogjia e tyre dhe veprat e tyre do t'u jepnin të drejtën ekskluzive të mbretërisë së qiellit. Në shëmbëlltyrën e atit dhe dy bijve, Jezusi vuri në dukje bindjet e tyre të shtrembëruara dhe u shpjegoi se falja e Perëndisë është për të gjithë mëkatarët, gjë që na sfidon ne t'i rrëfejme mëkatet tona para Perëndisë.

Jezusi tërhoqte turma kudo që shkonte, dhe Jeriko nuk përbënte përjashtim. Për shkak të numrit të madh që mblidhej, ndërsa Jezusi kalonte, një kryetagrambledhës i shkurtër dhe mëkatar i quajtur Zake, u ngjiti mbi një pemë për të parë Shpëtimtarin. Edhe pse njerëzit e urrenin Zakeun, Jezusi këmbënguli të shkonte në shtëpinë e tij atë ditë. Ndikimi i Jezusit tek Zakeu përmes shpëtimit është i qartë. Ai u shndërrua nga një kryetagrambledhës lakmitar në një ndjekës të përlulur dhe të penduar të Zotit. Historia e Zakeut na sfidon të ndryshohemi nga Jezusi.

Ndërsa jetës së Jezusit në tokë po i vinte fundi, Ai u kujdes shumë që t'u mësonte dishepujtë të Tij se çfarë duhet të bënin kur Ai të mos ishte më fizikisht me ta. Darka e Fundit ishte njëri nga këto raste. Në këtë festë të Pashkës – të kujtuarit e mënyrës se si Perëndia e kishte çliruar Izraelin nga Egjipti – Jezusi i udhëzoi dymbëdhjetë dishepujtë e Tij ta kujtonin Atë duke festuar Darkën e Zotit. Kjo festë e re do të ishte një rast i veçantë për të pirë nga kupa, duke kujtuar gjakun e Tij që u derdh, dhe për të

ngrenë nga buka, duke kujtuar trupin e Tij që u dha në vendin tonë. Sot, besimtarët ende festojnë Darkën e Zotit për të kujtuar atë që Jezusi ka bërë për ne.

Pas Darkës së Zotit ndodhën ngjarje shumë të rëndësishme për historinë njerëzore. Jezusi u arrestua, u gjykua, u shpall i pafajshëm, e megjithatë u dënua me vdekje në kryq si të ishte një kriminel i zakonshëm. Shpëtimtari i pamëkat i botës e dha veten me vullnet të plotë, që të torturohej e të vritej, duke marrë ndëshkimin tonë, që ne të merrnin falje për mëkatin. Në ditën e tretë, vdekja u mposht kur Jezusi u ngrit nga varri, i gjallë përgjithmonë, dhe na ofroi jetë të përjetshme nëse do të besojmë vetëm tek Ai. Prandaj mund të festojmë Pashkën, sepse mund të njohim personalisht se Jezusi është Shpëtimtari ynë i ngritur.

Pasi Jezusi ngjitet në qiell, filloi kisha e hershme. Dishepujt e ndanë Ungjillin dhe më tepër njerëz filluan të besonin dhe të ndiqnin Jezusin. U rrit edhe persekutimi për të krishterët, sidomos nga një farise i quajtur Saul, i cili njihej mirë për zemërimin e zellshëm që kishte kundër ndjekësve të Jezusit. Kjo derisa ai takoi Shpëtimtarin e ringjallur në rrugën për në Damask. Atëherë Sauli, armiku i përbetuar i Jezusit, bëri zgjedhjen e mençur që të dëgjonte dhe t'i bindej Birit të Perëndisë. Ashtu si Zakeu, Sauli u bë një njeri i ndryshuar, dhe ai na mëson të dëgjojmë dhe t'i bindemi me besnikëri Jezusit.

Pas konvertimit, Sauli iu bashkua shpejt dishepujve në ndarjen e Ungjillit. Udhëtimi i tij i parë misionar ishte me Barnabën (Veprat 13-14). Së bashku ata udhëtuan në Qipro dhe në Galati, pastaj u kthyen në Jerusalem për një kohë të shkurtër. Sot, do t'i bashkohemi Palit në udhëtimin e tij misionar në qytetin e Filipisë, ku do të njihemi me një grua të quajtur Lidia. Lidia ishte pagane, por adhuronte Perëndinë e hebrenjve. Kur Pali i predikoi asaj dhe grave të tjera, Perëndia hapi zemrën e Lidias dhe ajo besoi! Ajo u përgjigj me guxim, u pagëzua publikisht dhe i hapi shtëpinë e saj Palit dhe shoqëruesve të tij. Lidia e identifikoi shpejt veten si besimtare. Ajo u përkushtua me guxim në skuadrën e Jezusit.

Jezusi tha se Sauli do të vuante për Të dhe Sauli vuajti. Një ditë, pasi kishte çliruar një vajzë nga një frymë e ligë, Sauli, tashmë i njohur si Pali, bashkë me shoqëruesin e tij, Silën, u kapën, u rrahën keq dhe u hodhën në burg, dhe të dy u prangosën nga këmbët. Si reagues Pali dhe Sila? Ata u lutën dhe i kënduan himne Perëndisë! Kur Perëndia dërgoi një tërmet, Pali dhe të burgosurit e tjerë u liruan, por ata nuk ia mbathën. Rojtari po mendonte të vetëvritej, por Pali e ndaloi duke e siguruar se të gjithë të burgosurit ishin ende aty. Duke njohur besimin e Palit, rojtari e pyeti si mund të shpëtohej. Pali dhe Sila u përgjigjën me fjalët e njohura: “Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote” (Veprat 16:31) dhe rojtari e familja e tij u shpëtuan atë natë. Ashtu si Pali dhe Sila, qofshim të gjithë dëshmitarë të guximshëm për Jezusin!

Jezusi jo vetëm tha që Pali do të vuante për Të, por që Ai e zgjodhi Palin për t'u treguar edhe hebrenjve, edhe paganëve për Të. Që të përmbushte thirrjen e Perëndisë si misionar, Pali udhëtoi në vende të afërta dhe të largëta. Ai takoi njerëz që besonin në Perëndinë e vetëm të vërtetë dhe gjithashtu njerëz që besonin në shumë perëndi apo në asnjë perëndi. Pavarësisht se ku shkonte dhe pavarësisht cilat rreziqe haste, Pali shpalli me besnikëri emrin e Jezusit. Perëndia do që njerëzit të mësojnë për Jezusin dhe Ai do që ne t'u tregojmë atyre, siç bëri Pali. Qoftë pranë apo larg shtëpisë, qofshin njerëz që besojnë në Perëndinë e vetëm të vërtetë ose jo, Perëndia do që ne të themi: "Unë do të shkoj t'u tregoj të tjerëve për Jezusin."

Apostulli Pal u përball vazhdimisht me kërcënimin e vdekjes, ndërsa shkonte atje ku Perëndia donte që ai të shkonte. Hebrenjtë në Jerusalem e urrenin aq shumë Palin, saqë shkaktuan trazira në qytet; e nxorrën zvarrë Palin nga tempulli dhe u përpoqën ta vrisnin. Kur ushtarët romakë ndërhyrën, Pali u arrestua dhe u dërgua në Romë për t'u gjykuar nga Cezari. Sfidat e Palit vazhduan. Gjatë udhëtimit të tij për në Romë, ai përjetoi një stuhi të tmerrshme në det, anija u shkatërrua dhe pastaj u pickua nga një gjarpër helmues; të gjitha këtyre u mbijetoi për shkak të mbrojtjes së Perëndisë. Kur ne, ashtu si Pali, besojmë në Perëndinë, mund t'i pranojmë sfidat me të cilat përballemi dhe të themi: "Unë do t'i besoj Perëndisë për mbrojtje."

Sipas planit të Perëndisë, Pali arriti i sigurt në Romë. Edhe pse ishte i burgosur, Palit iu lejua të jetonte në shtëpinë e tij ku e ruante një rojtar romak, në vend që ta kyçnin në një burg. Miq dhe vizitorë mund të hynin e të dilnin lirisht, dhe shumë erdhën të dëgjonin atë që Pali kishte për të thënë. Gjatë dy viteve të Palit në Romë, kryeqyteti i perandorisë, Perëndia e përdori që t'u tregonte njerëzve nga e gjithë bota për Jezusin dhe se si ata mund të shpëtonin nga mëkati. Disa besuan dhe disa jo, por pavarësisht përgjigjes së njerëzve, Pali qëndroi i patundur dhe bëri atë që Perëndia donte prej tij. Bazuar në këtë, duhet t'i bëjmë vetes këto pyetje: A do të jetojmë një jetë si Pali? A do ta përkushtojmë jetën tonë për t'ua shpallur të vërtetën të tjerëve? A do të qëndrojmë të patundur për Jezusin edhe kur të tjerët nuk besojnë?

Ndërsa i afrohemi fundit të një tremujori tjetër, marrim një ditë për të kujtuar dhe festuar gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Pas kësaj, do të drejtohemi në Dhiatën e Vjetër ku do të zbulojmë për jetën e Jozefit në librin e Zanafillës.

MËSIMI 1

Luka 15:1-7

Kupto si duhet:	Jezusi u mëson njerëzve për delen e humbur.
Mendo si duhet:	“Sepse, me anë të hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, por është dhurata e Perëndisë, jo prej veprave që askush të mos mburret.” Efesianëve 2:8-9 (12 vargjet kyç)
Vepra si duhet:	Unë do të kërkoj njerëzit e humbur që kanë nevojë për Jezusin.
Ndihni si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar kur dikush gjendet nga Jezusi.

PËRGATITU!

A ke humbur ndonjëherë diçka me vlerë? Ndoshta një unazë, telefonin apo fëmijën në mes të një turme njerëzish. Me shumë mundësi ke nisur një kërkim me përqendrim lazeri për të gjetur atë që të kishte humbur. Si u ndieve ndërsa kërkoje me ngulm gjithandej derisa ajo që kishte humbur u gjet? Sot do të mësojmë rreth një kërkimi ngulmues për diçka të humbur frymëror.

Lutu: Lutur që Perëndia të të japë të kuptuarit e qartë të Shkrimit dhe që nxënësit në klasën tënde të kuptojnë nevojën e miqve të tyre për një Shpëtimtar.

Lexo: Luka 15:1-7

Kupto si duhet: Jezusi u mëson njerëzve për delen e humbur

Jezusi tregoi shëmbëlltyrën e deles së humbur për t'i ndihmuar njerëzit të kuptonin rëndësinë e arritjes së të humburve për Krishtin. Çdo dele ishte e vlefshme për Kryebariun dhe Ai i donte shumë ato. Kjo ngjarje na sfidon të kërkojmë vazhdimisht për njerëzit e humbur që kanë nevojë për Jezusin.

BËHU GATI!


Shënimet e mësuesit kryesor:

- A beson vërtet se njerëzit e humbur frymëror janë në rrezik? Ata janë në rrezik jo vetëm ndërsa jetojnë në këtë botë, por për përjetësinë. A e kupton nevojën urgjente për shpëtimin e të humburve? Nëse po, mësimi yt do të jetë plot pasion dhe energji. Nëse nuk u përgjigjesh dot me “po” këtyre pyetjeve, lutu dhe kërkoji Perëndisë të të ndihmojë t'i shohësh të humburit me sytë e Jezusit. Fol me drejtuesin e shërbesës së fëmijëve nëse ende nuk je i sigurt për nevojën urgjente për shpëtimin e të humburve.

- Cila është “mosha e llogaridhënies” për fëmijët? Shumë njerëz besojnë se mosha e llogaridhënies për fëmijët është rreth pesë vjeç, një kohë në të cilën ata mund të bëjnë dallimin e së mirës dhe së keqes. Nëse një fëmijë mësohet siç duhet që nga foshnjëria, siç e citon edhe 2 e Timoteut 3:15, ata do të jenë të mençur për të kuptuar shpëtimin. Po, çfarë ndodh me fëmijën që nuk mësohet? Ai fëmijë është në rrezik, sepse është i humbur pa Shpëtimtarin. Duhet të ndiejmë nevojën urgjente për t’u mësuar nxënësve Fjalën e Perëndisë, që të shpëtohen!

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Përdor mjete nga “Koha e zbulimit” përgjatë mësimit si pika për mësimdhënien. Rruazat e “Librit pa fjalë” mund të përdoren ndërsa rishikon Ungjillin, dhe topat e pambukut do t’i ndihmojnë nxënësit të mendojnë për një person të humbur që ata njohin, i cili ka nevojë për Jezusin.
2. Krijoni një tematikë feste në klasë. Ndërsa hyni, entuziazmohuni se ka një festë në klasë, por mos u tregoni nxënësve se përse ka festë. Ndërsa jep mësimin, zbulo përse po festoni – ka gëzim në qiell kur shpëtohet një i humbur! Tregojni nxënësve që byzylyku i “Librit pa fjalë” mund të përdoret si dhuratë për një mik dhe delja me topa pambuku është një kujtesë për t’u lutur për mikun e humbur.
3. Printo mini-postera të “Ndiu si duhet” (burim i printueshëm) për të gjithë nxënësit. Kërkoju nxënësve të qarkojnë ose të shënojnë emocionet që ata, ose miqtë e tyre, do të ndienin përgjatë mësimit. Ky mësim është plot emocione.
4. Nxënësit më të vegjël: Krijoni 100 dele me letër, duke përdorur kapëse rrobash si këmbë (të cilat do të ndihmojnë që delet të rrijnë në këmbë). Ndërsa nxënësit futen brenda, ftoj të ulen rreth tufës së deleve, duke krijuar një gardh njerëzor për delet. Të gjithë, përveç njërit prej tyre, duhet të jenë në qendër të dhomës. “Delja e humbur” duhet të jetë anash dhomës.



NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësitat gjenden te shtojca.


Koha e zbulimit: I humbur!

Qëllimi: T’u japim nxënësve përjetimin e të kërkuarit të gjërave shumë të rëndësishme që kanë humbur. Nxënësit do të nisin një kërkim thesari për të gjetur sende të humbura përpara përfundimit të kohës.

Aktiviteti: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Shtatë kova jeshile (kopshti – klasa e 2-të)
- Shtatë kova blu (klasa 3-të – klasa e 5-të)
- Dhjetë kova blu shtesë si kova ngatërruese për nxënësit më të rritur
- Rruazat e “Librit pa fjalë” (nga një grup për çdo nxënës)
- Lidhëse (në gjatësinë e duhur për byzylykë për çdo nxënës)
- Topa pambuku (nga një për çdo nxënës)
- Qese të vogla plastike që mbyllen, dhe brenda të jenë shtatë objektet që nxënësit duhet të gjejnë (burim i printueshëm) (nga një për çdo nxënës)
- Bori, zilka ose muzikë për të treguar përfundimin e kohës



Udhëzime për ambientin:

1. Mbushi kovat me një nga objektet e mëposhtme: rruaza (nga një ngjyrë për çdo kovë), lidhëse ose topa pambuku.
2. Fshihi kovat nëpër zonë.
3. Vendos kufij të qartë ku nxënësit mund të shkojnë ose nuk mund të shkojnë.
4. Cakto një vend ku duhet të qëndrojë çdo mësues (dhe vendi që duhet të gjejnë nxënësit në fund të kërkimit).
5. Vendos objekte shtesë në çdo klasë për nxënësit që nuk i kanë gjetur të gjitha objektet brenda kohës së caktuar.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Përpara se të përfundojë adhurimi, kërkoni njërit prej nxënësve të shpjegojë “Zbulimin e thesarit”.
2. Tregoju nxënësve se ku duhet ta gjejnë mësuesen e tyre në fund të zbulimit të thesarit, që të mos ketë ngatërresa. Disa nga alternativat mund të përfshijnë hapësirën e adhurimit, klasat, apo stacionet e “Kohës së zbulimit”.
3. Jepu nxënësve qese plastike që mbyllen ndërsa largohen nga koha e adhurimit (kjo mund të jetë një kohë e mirë për të bërë një numërim).
4. Thuaj: “Kemi humbur disa objekte shumë të rëndësishme që do të na duhen për mësimin sot. Qëllimi juaj është të kërkoni dhe të gjeni të gjitha objektet e humbura dhe të ktheheni tek mësuesja juaj sa më shpejt të mundeni. Në qese duhet të keni shtatë objekte të ndryshme. Mbidhni objekte vetëm nga kovat përkatëse sipas moshës. Nxënësi i parë që kthehet te mësuesja me shtatë objektet do të marrë dhjetë etiketa shpërblyese. Shtatë objektet që duhet të kërkoni janë të shkruara tek letrat që gjendet brenda çantës: një top pambuku, rruazat e “Librit pa fjalë” (secila nga ngjyrat e rruazave duhet të gjendet në kova të ndryshme), dhe një lidhëse për të formuar byzylykun.”

5. Përdor një bori, zilkë ose muzikë për t'i njoftuar nxënësit se kur përfundon koha.
6. Pasi të gjithë nxënësit të jenë kthyer te mësuesja, shkoni tek vendi ku do të shpjegohet mësimi.
7. Objektet shtesë do të jenë në klasë për të gjithë nxënësit që nuk i gjetën objektet në kohë.
8. Të gjithë vizitorët duhet të qëndrojnë me një drejtues ose të kenë partnerë një nxënës më të rritur.

Këshillë për “Kohën e zbulimit”: Për nxënësit më të rritur, krijo kova të ndryshme sipas klasës dhe shtojë sfidën që t'i gjejnë kovat sipas klasës.

Mundësi alternative

Mjetet:

- Qese plastike që mbyllen (nga një për çdo nxënës)
- Lidhëse (një copë me gjatësi të përshtatshme për byzylykë për çdo nxënës)
- Një kovë/legen i madh mbushur me këto objekte: rruazat me ngjyra të “Librit pa fjalë” (e verdhë, e zezë, e kuqe, e bardhë dhe jeshile) dhe topat e pambukut (sigurohu që të kesh mjaftueshëm rruaza dhe topa pambuku për secilin nxënës)
- Ngjytës shirit për të bërë vijën e nisjes – të paktën 6 metra larg legenit/kovës
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për ambientin: Paraprakisht, prijë lidhëset në gjatësi byzylykësh dhe vendosi brenda qeseve plastike.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Në vendin e caktuar të KZ-së, mblihduni të gjithë dhe shpjegoju nxënësve, me nxitim urgjent, që ata do të ndahen në dy skuadra dhe skuadrat do të garojnë për të kërkuar dhe gjetur objektet e humbura. Ruaj intensitet të lartë – kjo është një garë shpejtësie!! Të gjithë anëtarët e secilës skuadër do të duhet të gjejnë gjashtë objekte shumë të rëndësishme dhe ato objekte duhen gjetur sipas rendit të saktë.
2. Ndaje shpejt klasën në dy skuadra dhe cakto mësuesin kryesor dhe bariun si kapitenë të skuadrës.
3. Përforco udhëzimet ndërkohë që kapitenët e skuadrave shpërndajnë qeset plastike. Udhëzimet: të gjithë anëtarët e skuadrave duhet shpërndahen shpejt për të kërkuar dhe gjetur fillimisht rruazën e verdhë. Pasi TË GJITHË anëtarët e skuadrës të kenë gjetur rruazën e verdhë, skuadra fillon të kërkojë rruazën e zezë, ndjekur nga rruaza e kuqe, rruaza e bardhë, rruaza jeshile dhe një top pambuku. Skuadra e parë që përfundon do të marrë nga pesë etiketa shpërblyese për çdo anëtar.
4. Kërkoju të dyja skuadrave të rreshtohen në vijën e nisjes.

5. Kur skuadrat të jenë gati, filloni garën.
6. Përgjatë garës, kapitenët e skuadrave duhet t'i nxisin anëtarët të kërkojnë me nevojë urgjente dhe të gjejnë objektet e humbura.
7. Kur e gjithë skuadra të ketë përfunduar garën dhe t'i ketë gjetur të gjitha objektet, skuadra duhet të fillojë të festojë dhe të brohorasë!! Skuadra që përfundon e para do të marrë pesë etiketa shpërblyese për çdo nxënës.
8. Lejoje skuadrën tjetër të përfundojë shpejt dhe të gjejnë pjesën tjetër të objekteve, që të mund të ndjekin mësimin.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Gjatë KZ-së, keni kërkuar disa objekte të humbura. Ishte e mrekullueshme se sa shumë keni nxituar për të gjetur objektet e humbura. Përse donit aq shumë t'i gjenit? A hoqët dorë shpejt apo ishit të përqëndruar? A u dorëzua ndonjëri shpejt? Përse po ose jo? Në mësimin e sotëm, do të mësojmë se çfarë kërkon Jezusi ose kë kërkon Ai.

Ndërsa marrim mësimin, dua të shikoni se çfarë keni mbledhur gjatë “Kohës së zbulimit” dhe të gjeni se si lidhen me mësimin. Nxënësit duhet t'i kenë qeset pranë gjatë mësimit.

Lutu: *Ndërsa njëri nga nxënësit e nis mësimin me një lutje, inkurajoji të luten specifikisht që Perëndia t'u flasë përmes Fjalës së Tij dhe që çdo nxënës të dëgjojë me kujdes se çfarë ka për t'i thënë Perëndia.*

Zbulojë: *Shkruaj referencën e vargut, Luka 15:1, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 15:1. Mësoju se referenca është “adresa” e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve se Luka është libri, numri i parë është kapitulli, 15, dhe numri i dytë është vargu, 1. Ata që janë për herë të parë, dhe moshat më të vogla, mund të kenë nevojë për ndihmë. Nëse nxënësit kanë përparuar, mund të përdoret metoda “Stërviçja me shpata”.*

Çfarë është “Stërviçja me shpata?” Si mësues, ti thua: “Biblat lart!” Nxënësit duhet t'i shtrijnë krahët lart me Bibla drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet ta përsërisin pas teje. Pasi të gjithë nxënësit të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: “Nisuni!”. Nxënësi i parë që vendos gishtin te vargu, do të marrë një etiketë shpërblyese.

Pyeti nxënësit nëse Luka gjendet në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re. Renditni librat e Dhiatës së Re deri te Luka. Mund të kesh nxënës që i rendisin të gjithë librat e Dhiatës së Re apo të Vjetër, por qëllimi sot është t'u mësosh se si t'i gjejnë ato libra në Biblat e tyre.

Kronologjia: Drejtoje gishtin për nga periudha historike te figura që përkon në rreshtin e kronologjisë së Biblës. Thekso se Luka, shkrimtari i librit, ishte doktor.

Prezantim me tremujorin dhe mësimin nga Bibla: Mësimi i sotëm fillon me njerëzit e mbledhur rreth Jezusit. Ata ishin të etur dhe të gatshëm ta dëgjonin Jezusin. E po, thuajse të gjithë ishin gati ta dëgjonin Jezusin.

Përvijimi i Shkrimit: Luka 15:1-7

Njerëzit mblidhen rreth Jezusit për të dëgjuar

Lexo Luka 15:1-2

Përmbledhje: Çfarë nuk shkonte me farisenjtë? Edhe pse e lexonin dhe studionin Biblën (Dhiatën e Vjetër), ata dukeshin krenarë, dhe pyesnin përse mëkatarët e dëgjonin Jezusin. Ata kishin “mësuar si duhet” prandaj duhet të “mendonin si duhet”, por ata nuk “vepronin si duhet”. Ata gjykonin të tjerët dhe i quanin mëkatarë.

Sa herë jemi dhe ne kështu? E njohim Fjalën e Perëndisë, por zgjedhim të mos e zbatojmë. I gjykojmë të tjerët në bazë të standardeve tona, jo sipas standardit të Perëndisë. Ndoshta shohim njerëz në kishë ose në shkollë dhe mendojmë se jemi më të mirë se ta. Ky është mëkat, dhe është i ngjashëm me atë që po bënin farisenjtë.

Jezusi e dinte se çfarë po mendonin farisenjtë, prandaj nisi t’u tregonte një shëmbëlltyrë. Shëmbëlltyra është një histori me kuptim shumë të veçantë.

99 delet

Lexo Luka 15:3-4a

Përmbledhje: Imagjinoni bashkë me mua të gjitha delet që hyjnë brenda gardhit... 95, 96, 97, 98, 99... Pa prit, numri 100 mungon! Le ta mendojmë kështu: kishe 100 dele dhe të humbi njëra. Kjo do të thotë se ke mbajtur 99% dhe ke humbur vetëm 1%. Nuk është edhe aq keq, apo jo? A nuk duhet të festojmë që thuajse çdo dele e bardhë me leshin e butë ishte e sigurt brenda gardhit? Çfarë do të kishe bërë ti? Si do të ishte ndier po të kishe qenë ti bariu? Referoju posterit të “Ndihi si duhet”.

Njëra dele

Lexo Luka 15:4b

Përmbledhje: Për bariun e kësaj shëmbëlltyre, një dele e humbur është çështje shumë e rëndësishme. Secila dele ishte e vlefshme dhe ai e dinte se delja e humbur do të ishte në rrezik të madh po të mos gjendej. Cilat do të

ishin rreziqet që do t'i kanoseshin? (kafshët e egra, shkëmbinjë, shkurret me gjemba, etj.)

Përse po mësojmë për delet? Bibla na mëson se Jezusi është Bariu i mirë dhe se ne jemi delet e Tij. Delet kanë nevojë për një bari që t'i drejtojë, t'i mbrojë dhe t'i shpëtojë nga rreziku. Ne kemi nevojë që Jezusi të na drejtojë, të na mbrojë dhe, më e rëndësishmja, të na shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit. Si ndihesh kur mëson se Jezusi është Bariu i mirë?

Lexo Isaia 53:6

Përmbledhje: Në këtë moment, disa prej nesh e dimë se Jezusi është Bariu ynë i dashur, i mrekullueshëm. Madje, ne e kujtojmë ditën kur u gjetëm, ditën kur donim që Ai të na shpëtonte nga mëkati ynë dhe të bëhej udhëheqësi i jetës sonë. Çfarë dite e mrekullueshme ishte! Por, disa prej nesh janë ende të humbur, pak a shumë si delja e humbur në mësimin e sotëm nga Bibla.

I vendosur ta gjente delen

Lexo Luka 15:5-6

Përmbledhje: A e vure re? Thuhet: “Dhe kur ta gjejë.” Nuk thotë “nëse e gjen.” Ai është i vendosur ta gjejë delen e humbur. Kjo më kujton se sa shumë e do Perëndia secilin prej nesh. Çdo person në këtë klasë është shumë i rëndësishëm dhe i vlefshëm për Perëndinë. Ai do që ti të jesh i shpëtuar dhe i sigurt se do të shkosh në qiell.

Dëgjoni se çfarë ndodhi pasi delja e humbur u gjet – filloi festa!

Festa në qiell

Lexo Luka 15:7

Përmbledhje: Jezusi feston me ata që vërtet pendohen dhe shpëtojnë nga mëkatet e tyre. A e imagjimon dot një festë në qiell? Fjalët nuk do të mund ta përshkruanin se si është. Në qiell ka festë sa herë që një person shpëton nga ndëshkimi i mëkatit dhe bëhet pjesë e familjes së madhe të Perëndisë. Bibla gjithashtu thotë se emri i tij shkruhet në një libër shumë të veçantë në qiell. Libri quhet libri i jetës së Qengjit (Zbulesa 21:27).

Përfundimi

A i ke kërkuar ndonjëherë Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të bëhet udhëheqësi i jetës tënde? A ka festuar qielli për ty? Nëse jo, Jezusi po të thërret dhe Ai dëshiron që ti të dëgjosh zërin e Tij dhe ta ndjekësh Atë (Gjoni 10:27).

Së pari, duhet të pranosh se je mëkatar (fleta e zezë tek “Libri pa fjalë”) dhe se ke nevojë për një Shpëtimtar – dikë që të shpëton nga mëkati yt (faqja e kuqe). Për shkak se Jezusi të do kaq shumë, Ai mori ndëshkimin për mëkatin tënd dhe vdiq në kryq për ty. Ai është i vetmi që mund të të shpëtojë nga mëkati dhe të të mirëpresë në familjen e Tij të jashtëzakonshme. A ju kujtohet Gjoni 14:6? Ky është një varg nga 12 vargjet kyç; recitojeni së bashku. Kjo është një zgjedhje që vetëm ti mund ta bësh.

Le të ulim kokat. Nëse tashmë ke besuar në Zotin Jezus dhe i ke kërkuar të të shpëtojë nga mëkati, merr kohë për ta falënderuar Jezusin që vdiq në kryq për të të shpëtuar. Ndoshta nuk je i sigurt, je i hutuar ose dëshiron të bësh pyetje. Mund të shkosh në anë të dhomës ose në korridor për të folur më shumë me një drejtues ose mund të flasësh me mua më vonë.

Mbylle me lutje.

Vepro si duhet dhe Ndihi si duhet

Nxënës, nëse tashmë jeni shpëtuar dhe jeni të sigurt se e keni pranuar Jezusin si Shpëtimtarin tuaj, a ju interesojnë ata që janë të humbur në lagjen, shkollën, qytetin tuaj, apo në botë? Ashtu si Jezusi e deshi delen e humbur, edhe ju duhet t’u tregoni të tjerëve për Jezusin me të njëjtën nevojë urgjente që kishit kur kërkuat delen e humbur (topi i pambukut) dhe “Librin pa fjalë”, ruazat me ngjyra, gjatë “Kohës së Zbulimit”.

Kjo më kujton diçka. Mbaj një nga qeset me objektet nga “Koha e zbulimit”. Do të doja të merrnit ruazat dhe të bënit një byzylyk që ju kujton rëndësinë e ndarjes së Lajmit të mirë të Jezusit me miqtë. Gjithashtu, dua që të merrni delen prej topi pambuku dhe ta vendosni në një vend në shtëpi që do t’ju kujtojë të luteni për ata që janë të humbur.

Ashtu si delja ishte e çmuar, por në rrezik, po ashtu janë miqtë tuaj që nuk e njohin Jezusin. Ata janë në rrezik dhe mund të mos shkojnë në qiell dhe në rrezik, sepse mund të jetojnë një jetë këtu në tokë pa Jezusin.

Si ndihesh për këtë? *Drejtohu te posteri “Ndihi si duhet” dhe lejoji nxënësit të ndajnë.*

Si do të ndiheshit nëse ata do të besonin në Jezusin? (të gëzuar, të lumtur) A je ti si farisenjtë apo si Jezusi kur sheh njerëz që nuk e njohin? A je i gatshëm të shkosh e t’u tregosh njerëzve të humbur për Jezusin?

Alternativë për nxënësit më të vegjël: Para se të lutemi, le të mendojmë për çfarë kemi mësuar sot dhe të shohim këtë video: “Shëmbëlltyra e deles së humbur.”
<https://www.youtube.com/watch?v=tyWZeOlaRo4>

Alternativë për nxënësit më të rritur: Le të praktikojmë ndarjen e Ungjillit me një mik duke përdorur ruazat e “Librit pa fjalë”.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. I detë për lojë gjenden te shtojca.

1. Në fillim të mësimit, kush po e dëgjonte Jezusin? (Mëkatarët)
2. Kujt nuk u interesonte vërtet Jezusi? (Farisenjve)
3. Çfarë është një farise? (Drejtues fetar që di shumë për Perëndinë, por nuk praktikon atë që ka mësuar)
4. Përse ishte e rëndësishme të kërkohej delja e humbur? (Delja ishte e çmuar dhe ishte në rrezik)
5. Çfarë bëri bariu kur gjeti delen e humbur? (Ai bëri një festë)
6. Çfarë ndodh në qiell kur dikush shpëtohet? (Ka festë)
7. Sa i shqetësuar je ti për njerëzit e humbur që nuk e njohin Jezusin?
8. Çfarë mund të bësh ti për t'u treguar të tjerëve për Jezusin? (Trego "Librin pa fjalë" në shkollë, në autobus, në dyqan, në lagje apo në shtëpinë e një mik, fto një mik në kishë etj.)